



|                                                                                 |                                        |                             |                    |
|---------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|-----------------------------|--------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS<br>REPUBLIKA KOSOVA<br>KOMUNA E LIPJANIT<br>OPŠTINA LIPLJAN |                                        |                             |                    |
| PRANUAR I Ë:<br>PRIMIENODANA: 02.09.2026                                        |                                        |                             |                    |
| NR. JESIA<br>JEDINICA                                                           | NR. KLASHIKIMIT<br>KL. KLASHIFIKACIONE | NR. LËNDËS<br>NR. PËRSONETA | SHTOJCA<br>PRILLOD |
| 05-020/04-45898                                                                 |                                        |                             |                    |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtori i DKRS-së shpallë:

**NJOFTIM PUBLIK**  
**PËR DORËZIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTARË NË KOMISIONIN VLERËSUES**  
**“PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE TË KLUBEVE SPORTIVE NË FUSHËN E**  
**SPORTIT PËR KATEGORINË E SENIORËVE PËR VITIN 2026”**

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të shoqërisë civile se mund t'i dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të financimit të projekteve të OJQ-ve që do të aplikojnë sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.05-453/01-01-43556 të datës: 25.08.2026.

Komisioni do të formohet me qëllim të financimit të projekteve të klubeve sportive në fushën e sportit për kategorinë e seniorëve për vitin 2026, ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit.
- Një përfaqësues nga OJQ-të.

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t'i drejtohen Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për shërbime me qytetar sportelet nr. 1 dhe 2, jo më vonë se data **14.09.2026**.

Lipjan, më 02.09.2026

Astrit Buja  
Drejtor i DKRS-së

